

Fondi i Pensionit Privat
“Credins Pension”

Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(me Raportin e Audituesit të Pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i audituesve të pavarur	i-iii
Pasqyra financiare:	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim ose humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse	2
Pasqyra e flukseve monetare	3
Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto	4
Shënime për pasqyrat financiare	5 - 22
Skedulet suplementare	23-24

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Personat e Ngarkuar me Qeverisjen e Fondit të Pensionit Vullnetar "Credins Pension" dhe shoqërise administruese të fondeve "Credins invest sh.a.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Pensionit Vullnetar "Credins Pension" ("Fondi i Pensionit Vullnetar"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse, të ndryshimeve në aktivet neto dhe të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Pensionit Vullnetar më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi i Pensionit Vullnetar në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare dhe Personave të ngarkuar me Qeverisjen

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit të Pensionit Vullnetar për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin e Pensionit Vullnetar ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit të Pensionit Vullnetar.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshe e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit të Pensionit Vullnetar.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit të Pensionit Vullnetar për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi i Pensionit Vullnetar të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit të Pensionit Vullnetar "Credins Pension" dhe shoqërise administruese të fondeve "Credins invest sh.a. përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë Raportin Vjetor, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Fondit të Pensionit Vullnetar për vitin 2024 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Bujar Bendo

Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 24 shkurt 2025




Fondi i Pensionit Privat "Credins Pension"**Pasqyra e pozicionit financiar***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	7	22,780,570	39,367,573
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar (KA)	8	2,488,758,602	2,011,523,998
TOTAL AKTIVE		2,511,539,172	2,050,891,571
DETYRIME			
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	9	4,230,069	3,455,745
Taksa të pagueshme		1,137,711	749,803
TOTAL DETYRIME		5,367,780	4,205,548
VLERA E AKTIVEVE NETO QE U ATRIBUOHET MBAJTESVE TE KUOTAVE		2,506,171,392	2,046,686,023
Numri i kuotave		1,424,861.7003	1,214,135.2499
Vlera e aktiveve neto për kuotë		1,758.8875	1,685.7150

Këto pasqyra financiare të Fondit Pensionit Privat "Credins Pension" u aprovuan nga Drejtimi i Shoqërisë Administruese "Credins Invest" më datë 27 Janar 2025 dhe u firmosën në emër të tyre nga:



Estela Koci
Drejtore Ekzekutive



Armira Çitozi
Drejtore Finance

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”**Pasqyra e fitim ose humjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhurat			
Të ardhura nga interesi	10	141,821,606	112,848,555
Fitim/humbje neto realizuar nga shitja e instrumentave financiare me kosto të amortizuar		(397)	43,855
Të ardhura të tjera		(138)	(494)
Total të ardhurat		141,821,071	112,891,916
Shpenzime			
Tarifa e administrimit	11	45,428,772	37,193,980
Total shpenzime		45,428,772	37,193,980
Fitimi i vitit		96,392,299	75,697,936
Të ardhura/(humbje) të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Rritja në aktivet neto nga operacionet që i atribuohet mbajtësve të kuotave		96,392,299	75,697,936

Pasqyra e fitim ose humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”**Pasqyra e flukseve monetare***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
<i>Flukset monetare nga aktiviteti operativ</i>		
Rritje në vlerën e aktiveve neto	96,392,299	75,697,936
Rregullime për:		
(Fitim)/humbje e realizuar nga maturimi i investimeve të mbajtura në maturim dhe të tjera	397	(43,855)
Të ardhura nga interesi	(141,821,606)	(112,848,555)
Tarifa administrimi	45,428,772	37,193,980
<i>Ndryshimet në:</i>		
Blerje e titujve të mbajtura me kosto të amortizuar	(506,058,258)	(376,023,158)
Blerje e titujve të mbajtura përmes VDATGJ		
Investime të maturuara	40,300,000	28,400,000
Investime të shitura të mbajtura përmes VDATGJ	-	-
Rritje neto në detyrimet e tjera	387,908	258,023
Interes i arkëtuar	130,344,860	103,849,577
Tarifa e administrimit e paguar	(44,654,447)	(36,589,155)
Flukse monetare të përdorura në aktivitetet operative	(379,680,075)	(280,105,207)
Flukse monetare nga aktivitetifinancues		
Flukse hyrëse nga anëtarët e fondit	447,388,966	378,516,170
Tërheqje monetare për pagesat e pensione	(36,093,973)	(34,693,967)
Flukse dalëse nga tërheqje të parakohshme	(46,722,068)	(61,241,816)
Flukse dalëse nga tranferimet	(1,479,855)	-
Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin financues	363,093,071	282,580,387
Ulje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to	(16,587,004)	2,475,179
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 1 Janar	39,367,574	36,892,394
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	22,780,570	36,892,394

7

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”**Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitimi neto nga investimet në tituj	96,392,299	75,697,936
Rritje në aktivet neto nga operacionet që i atribuohet mbajtësve të kuotave	96,392,299	75,697,936
Flukset hyrëse nga anëtarët e fondit	447,388,966	378,516,170
Flukset dalëse mbi bazën e transferimeve	(1,479,855)	-
Flukset dalëse mbi bazën e pagesave të pensioneve periodike	(8,929,843)	(322,577)
Flukset dalëse mbi bazën e pagesave të pensionit	(27,164,130)	(34,371,390)
Flukset dalëse mbi bazën e tërheqjeve të parakohëshme	(46,722,068)	(61,241,816)
Rritje neto në aktivet neto nga transaksionet me anëtarët e fondit	363,093,070	282,580,387
Totali i rritjes në aktivet neto	459,485,369	358,278,322
Aktivitet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave		
Në fillim të periudhës	2,046,686,023	1,688,407,700
Në fund të periudhës	2,506,171,369	2,046,686,023
Numri i kuotave në fillim të periudhës	1,214,135.2499	1,043,177.7916
Kuota të emetuara mbi bazën e hyrjeve të kontributeve	259,539.9884	228,900.4913
Kuota të tërhequra mbi bazën e transferimeve	(862.3390)	-
Kuota të tërhequra mbi bazën e pagesave të pensionit periodik	(5,162.5000)	(197.0154)
Kuota të tërhequra mbi bazën e pagesave të pensionit	(15,699.3255)	(20,750.5293)
Kuota të tërhequra mbi bazen e pagesave të parakohshme	(27,089.3735)	(36,995.4883)
Numri i kuotave në fund të periudhës	1,424,861.7003	1,214,135.2499

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. ENTITETI RAPORTUES

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension” (“Fondi i Pensionit”) është një fond me kontribute të përcaktuara i autorizuar me vendimin nr.173, datë 13 dhjetor 2011 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”).

Aktiviteti Kryesor

Qëllimi i Fondit është rritja e kapitalit me qellime afat mesme dhe afatgjata duke tregtuar portofolin e investimeve në letra me vlerë të leshuara kryesisht nga Qeveria Shqiptare. Fondi është nën administrimin e “Credins Invest Sh.a. (“Shoqëria Administruese”) e cila është licensuar fillimisht nga AMF më 23 Nëntor 2021 duke i aprovuar emertimin aktual më 30.05.2016. Shoqëria e Administrimit administron aktivet e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive së bashku me administrimin e fondit të pensioneve vullnetare.

Gjatë vitit 2023, ligji aktual nr. 10197 “Për fondet e pensioneve vullnetare” u zëvendësua nga ligji i ri nr. 76/2023 “Për fondet e pensioneve private”, i cili hyri në fuqi më 6 nëntor 2023. AMF miratoi gjatë 2023 dhe 2024 aktet nënligjore në zbatim të ligjit brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij, ndërsa procesi i përputhshmërisë së veprimtarisë së shoqërive administruese dhe fondeve të pensioneve ekzistuese duhet të kryhet brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Fondi i pensionit bashkë-zotërohet nga të gjithë kontribuesit e fondit, nën një bashkëpronësi të ndarë, që përfaqësohet në kuota të fondit të pensionit dhe nuk është një entitet ligjor dhe nuk ka personalitet juridik. Çdo kuotë përfaqëson pronësinë proporcionale mbi aktivet e fondit të investimit. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar Bankën Tiranë si bankë depozitare të Fondit për 31 Dhjetor 2024 dhe 2023. Shoqëria dhe Depozitari janë të detyruara të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta, nga aktivet, veprimet, dhe regjistrimet e Fondit të Pensionit. Për këtë arsye, regjistrimet kontabël dhe raportimet për Fondin e Pensionit dhe shoqërinë administruese mbahen dhe paraqiten të ndara.

Zyra e Rregjistruar

Shoqëria e Administrimit e Fondit ka selinë në Rrugën “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.

2. BAZAT E KONTABILITETIT

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF. Ato janë autorizuar për tu raportuar nga drejtimi i Shoqërisë Administruese me 27 Janar 2025.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, duke qënë se Shoqëria Administruese është e kënaqur se Fondi ka burime të përshtatshme për të vazhduar si një entitet me vijueshmëri për të ardhmen e parashikueshme. Në kryerjen e këtij vlerësimi, drejtimi ka konsideruar një gamë të gjërë informacioni përshirë edhe projekte të fitueshmërisë, kërkesave të kapitalit rregullator dhe nevojave të financimit. Ky vlerësim përfshin gjithashtu edhe marrjen në konsideratë të skenareve ekonomike të mundshëm të përkeqësimit dhe ndikimeve mundshme mbi fitueshmërinë, kapitalin dhe likuiditetet e Fondit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, përveç aktiveve financiare në instrumenta borxhi të mbajtura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (VDATGJ).

Detajet e politikave kontabël të Fondit, përfshirë ndryshimet në to, janë të paraqitura në Shënimin 5

3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e fondit. Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe. Transaksionet dhe investimet e Fondit janë në Lek ashtu si dhe investimet dhe tërheqjet e kuotambajtësve janë percaktuar në bazë të vlerës së aktiveve neto të arkëtuara dhe të paguara në Lek.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE KONTABËL

Në përgatitjen e ketyre pasqyrave financiare, drejtimi ka kryer gjykime dhe çmuarje të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet. Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prespektive.

A. Gjykimet

Informacioni mbi gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektet më domethënëse në shumën e njohur në pasqyrat financiare, përfshihet në shënimet e mëposhtme:

Shënimi 5 (b): njohja e të ardhurave- nëse të ardhurat njihen me kalimin e kohës apo në një moment të caktuar.

B. Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive

Informacioni mbi vlerësimin e pasigurive të cilat në datën e raportimit kanë një rrezik domethënës duke rezultuar në një ndikim të rëndësishëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhet në paragrafët në vijim:

- Shënimi 5.(g) – zhvlerësimi i instrumentave financiar, përcaktimin e të dhënave në modelin e matjes së HPK-se, së bashku me përfshirjen e informacionit për të ardhmen;

5. POLITIKA MATERIALE KONTABËL

Fondi ka aplikuar në mënyrë konsistente politikat kontabël në vijim të të gjitha periudhave të raportuara në këto pasqyra financiare, .

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit aktual në fund të vitit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të matur me vlerën e drejtë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Monedha EUR u shkëmbye me 31 dhjetor 2024 me kurs këmbimi prej Lek 98.15 (31 dhjetor 2023: Lek 103.88)

5. POLITIKA MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(b) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse përbëjnë interesin në aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar dhe llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Norma e interesit efektiv llogaritet në njohjen fillestare të një instrumenti financiar si norma që skanton saktësisht pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme dhe arkëtimet gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar deri në:

- vlerën kontabël bruto të aktivit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Në përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, norma efektive e interesit aplikohet mbi vlerën kontabël bruto (kur aktivi nuk është me kredit të zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit. Megjithatë, për aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten mbi normën e interesit efektiv të koston së amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk është më me kredit të zhvlerësuar, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi kthehet mbi bazën bruto.

(c) Të ardhurat neto nga instrumentat financiare me VDATGJ

Të ardhurat neto nga instrumentat financiare me VDATGJ përfshijnë të gjithë ndryshimet në vlerën e drejtë të realizuar dhe të parealizuar dhe diferencat e kursit të këmbimit, të ardhura nga interesi.

(d) Shpenzimet për tarifat dhe komisionet

Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve njihen në fitim ose humbje pasi shërbimet e lidhura janë marrë.

(e) Njësia e investuese dhe konsolidimi

Fondi ka investitorë të shumëfishtë dhe mban investime të shumta. Pasqyrat financiare të Fondit nuk janë të konsoliduara me pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese. Fondi konsiderohet të përmbushë përkufizimin e një njësie investuese sipas SNRF 10 nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme:

- (a) Fondi ka marrë fonde me qëllim të ofrimit të investitorëve shërbime profesionale të administrimit të investimeve.
- (b) Qëllimi i biznesit të Fondit, i cili u komunikohet drejtpërdrejtë investitorëve, është investimi për vlerësime të kapitalit dhe të ardhurat nga investimet.
- (c) Investimet maten dhe vlerësohen në bazë të vlerës së drejtë (përveç atyre të klasifikuara si të mbajtura me kosto të amortizuar).

(f) Vlera e Aktiveve Neto e kuotambajtësve

Aktivitet neto përfaqësojnë kontributet në para dhe kthimin nga investimi në këto kontribute pa pagesat dhe komisionet për Shoqërinë Administruese të kontribuesve të fondit të pensioneve të konvertuara në kuota. Çdo kuota përfaqëson një pjesë proporcionale të pronësisë mbi çdo pasuri të Fondit. Kuotat i referohen shumës totale të kontributeve të ndara me vlerën e njësisë kontabël.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. POLITIKA MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Fondi njeh fillimisht llogaritë e arkëtueshme, depozitat dhe investimet në letrat me vlerë në datën kur ato krijohen. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (përfshirë blerjen dhe shitjen me mënyrë të rregullt të aktiveve financiare) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën Fondi bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv financiar ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Klasifikimi i Aktiveve Financiare

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me kosto të amortizuar ose me VDATGJ.

Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me VDPFH:

- aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja mbledhja e flukseve monetare kontraktuale; dhe,
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar gjenerojnë në datat e caktuara flukse monetare, të cilat përbëjnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar.

Të gjitha aktivet e tjera financiare të Fondit klasifikohen të matura me VDATGJ.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Në kryerjen e vlerësimit të objektivave të modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv financiar, Fondi merr në konsideratë të gjithë informacionin më të mirë sesi menaxhohet biznesi, përfshirë:

- strategjinë e dokumentuar të investimeve dhe zbatimin e kësaj strategjie në praktikë. Kjo përfshin nëse strategjia e investimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet kjo performancë drejtimit të Fondit;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe si menaxhohen këto rreziqe;
- si kompensohen menaxherët e portofoleve - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset e mjeteve monetare kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve për periudhat e kaluara, arsyet e të tilla shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve.

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Fondit.

Fondi ka përcaktuar se ka dy modele biznesi:

–Modeli i biznesit “mbajtur për të mbledhur”: ky përfshin mjetet monetare dhe ekuivalente me to dhe disa investime në letra me vlerë. Fondi konsideron se këto investime në letra me vlerë janë pjesë e një modeli biznesi qëllimi i të cilit është për t’i mbajtur aktivet për të mbledhur flukset monetare kontraktuale.

– Modeli tjetër i biznesit: Ky përfshin investime në letra me vlerë të tjera të mbajtura nga administratorët e Fondit në një portofol më vete për të plotësuar nevojat e likuiditeteve ditore. Portofoli i Fondit ka si qëllim të minimizojë kostot e administrimit të nevojave për likuiditet dhe për rrjedhojë administron aktivisht kthimin e portofolit. Ky kthim konsiston në arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale ashtu si dhe fitime ose humbje nga shitja e aktiveve financiare. Strategjia e investimit shpesh rezulton në aktivitete shitjeje që janë domethënëse në vlerë. Fondi konsideron që këto aktive financiare janë të mbajtura si pjesë e një modeli biznesi objektivi i të cilit arrihet si duke mbledhur të drejtat kontraktuale të flukseve monetare, ashtu edhe duke aktivet financiare.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension” Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. POLITIKA MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit

Për qëllim të këtij vlerësimi, ‘principal’ është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. ‘Interesi’ përkufizohet si konsideratë për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën ose shumën e flukseve monetare;
 - kushtet e levës
 - parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
 - kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme); dhe
- karakteristikat që modifikojnë konsideratën e vlerës në kohë të parasë (p.sh. rivendosja periodike e normave të interesit).

Riklasifikimet

Aktivitetet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç nëse Fondi në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit për manaxhimin e aktiveve financiare, dhe në atë rast të gjithë aktivitetet e prekura do të riklasifikohen në ditën e parë të periudhës raportuese të parë që vijon ndryshimin në modelin e biznesit.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivitetet financiare me koston e amortizuar	Këto aktive maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.
Investimet në letra me vlerë me VDATGJ	Këto aktive maten më pas me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Fitime dhe humbjet e tjera neto njihen në ATGJ. Në momentin e çregjistrimit, fitime ose humbje të akumuluar në ATGJ riklasifikohen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet

Detyrimet financiare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar. Detyrimet financiare pas njohjes fillestare maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit njihen në fitim ose humbje. Detyrimet financiare me kosto të amortizuar përfshijnë balancat e detyrime ndaj shoqërisë administruese.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”

Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. POLITIKA MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iii) Matja e vlerës së drejtë

‘Vlera e drejtë’ është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet “aktiv”, në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi. Fondi e mat instrumentin e kuotuar në treg aktiv me çmimin mesatar, sepse ky çmim përfaqëson një përafrim të arsyeshëm të çmimit të shitjes.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Fondi përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Fondi njeh transferimin ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

(iv) Kosto e Amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, shtuar ose zbritur amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(v) Zhvlerësimi

Fondi njeh një zbritje për HPK për aktivet financiare me koston e amortizuar

Shoqëria njeh një zbritje për HPK për një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivitetit, përveç sa me poshtë për të cilat llogariten me HPK 12-mujore.

-aktive financiare të cilat vlerësohen të kenë një rrezik të ulët kredie në datën e raportimit; dhe

- aktive të tjera financiare, për të cilat rreziku i kredisë (p.sh rreziku i dështimit përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar) nuk është rritur ndjeshëm nga momenti i njohjes së tyre fillestare.

Në përcaktimin nëse rreziku i kredisë i një aktivi financiar është rritur në mënyrë domethënëse që nga njohja fillestare dhe kur vlerësohet HPK, Fondi merr në konsideratë informacion të mbështetur dhe të arsyeshëm që është relevant dhe i disponueshëm pa patur kosto dhe perpjekje shtesë. Kjo përfshin informacion dhe analizë sasiore dhe cilësore, duke u bazuar në eksperiencën historike të Shoqërisë dhe vlerësime kredie të informuara që përfshijnë edhe informacione të ardhshme.

Fondi konsideron që rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë domethënëse nëse është më shumë se me 30 ditë vonesë pa paguar.

Fondi e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Fondit pa masa shtrënguese nga ana e Fondit siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;

- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

. Në lidhje me investimet në letra me vlerë të emetuar nga shoqëri tregtare, Fondi e konsideron me rrezik kredie të ulët kur niveli i rrezikut të kredisë është ekuivalente me Baa3 ose më lart sipas Moody’s ose BBB- ose më lart sipas Standard and Poor’s instrumenta borxhi privat ashtu si specifikuar në limitet rregullatore.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. POLITIKA MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(v) Zhvlerësimi (vazhdim)

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivitetit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit (ose një periudhë me e shkurtër nëse jeta e pritshme e instrumentit është me pak se 12 muaj).

Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Fondi është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

Matja e HPK

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t'i paguhet Fondit në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Fondit pret të marrë).

HPK janë skontuar me normën efektive të aktivitetit financiar.

Aktivitet financiar të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Fondi vlerëson nëse aktivitet financiar të mbajtura me koston e amortizuar janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse ka ndodhur një ose më tepër ngjarje që kanë ndikim të ndjeshëm në flukset monetare të ardhshme.

Të dhënat e verifikueshme që tregojnë se një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë:

- vështirësi të mëdha financiare të debitorit;
- shkelje e kontratës ose debitori është më tepër se 90 ditë me vonesë në kryerjen e pagesës;
- është e mundur që debitori do të falimentojë ose do të riorganizohet financiarisht.

Paraqitja e zbritjes për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar.

Humbjet për aktivitet financiar të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Fondi nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivitetit financiar.

(vi) Çrregjistrimi

Fondi çrregjistron shitjet e zakonshme të aktiveve financiare duke përdorur kontabilitetin e datës së tregtimit. Një aktiv financiar çrregjistrohet kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktiviteti financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Me çrregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit (ose vlera kontabël e alokuar tek pjesa e aktivitetit që është çrregjistruar) dhe pagesa e marrë në çrregjistrimin (përfshirë edhe ndonjë aktiv të ri të përfituar neto nga ndonjë detyrim të njohur) njihet në fitim ose humje. Ndonjë interes në një aktiv financiar të tillë të transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Fondi njihet si aktiv ose detyrim më vete.

Fondi bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivitet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Nëse të gjitha ose pothuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve janë të mbajtura, atëherë aktivitet e transferuara nuk çrregjistrohen. Transferimet e aktiveve me mbajtjen e të gjitha ose pothuajse të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve përfshijnë transaksionet me shitje dhe riblerjeje.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”

Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. POLITIKA MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vi) Çrregjistrimi (vazhdim)

Fondi çregjistron një detyrim financiar kur parashikimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati.

Me çrregjistrimin e detyrimit financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivit që çregjistrohet dhe shumës së paguar (përfshirë edhe ndonjë aktiv jo në para të transferuar ose detyrim të njohur) njihet në fitim ose humbje.

Fondi e çregjistron një derivativ vetëm kur plotësohet kriteri i çrregjistrimit për të dy, aktivet financiare dhe detyrimet financiare. Aty ku pagesa ose arkëtimet e marzhit të ndryshimit përfaqëson një mbyllje të derivativit, derivativi ose pjesa e mbyllur çregjistrohet.

(vii) Kompensimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Fondi gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet janë paraqitur të netuara për fitimet dhe humbjet nga instrumenta financiar me VDATGJ dhe fitim dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

(viii) Instrumenta të veçantë

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë depozitat me bankat dhe aktive financiare me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël dhe janë subjekt i një rreziku jodomethënës të ndryshimit të vlerës së drejtë të tyre si dhe perdoren nga Fondi në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

(h) Standarde të reja por jo në fuqi

Një numër standardesh të reja kanë hyrë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar pas datës 1 janar 2024 dhe zbatimi i hershëm është i lejuar Megjithatë, Fondi për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare nuk ka zbatuar paraprakisht standardet e reja dhe të amenduara financiare dhe nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Fondit.

A. SNRF 18 Prezantimi dhe zbulimi në Pasqyrat Financiare

SNRF 18 do të zëvendësojë SNK 1 -Paraqitja dhe Zbulimi në Pasqyrat Financiare dhe do të zbatohet për periudhat raportuese vjetore që fillojnë me 1 janar 2027 ose më vonë. Ky standard i ri prezanton kërkesat kryesore të mëposhtme:

- Entitetet duhet të klasifikojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në pesë kategori në pasqyrën e fitimit ose humbjes, konkretisht: operacionale, investimi, financimi, operacione të ndërprera dhe tatim mbi të ardhurat. Entitetet duhet gjithashtu të paraqesin një nën total të ri të përcaktuar për fitimin operativ. Megjithatë, fitimi neto i entitetit nuk do të ndryshojë.
- Matja e përcaktuar e ecurisë nga manaxhimi duhet të zbulohen në një shenim të vetëm në pasqyrat financiare.
- Ofron udhëzime të përmirësuara mbi mënyrën se si duhet grupuar informacioni në pasqyrat financiare.

Për më tepër të gjitha entitetet duhet të përdorin nën totalin e fitimit operativ si pikënisje për pasqyrën e flukses të parasë kur paraqesin flukset e parasë nga aktivitetet operacionale sipas metodës indirekte.

Fondi është ende në procesin e vlerësimit të ndikimit të këtij standardi të ri, ëveçanërisht në lidhje me strukturën e pasqyrës së fitimit ose humbjes, pasqyrën e flukseve të parasë dhe kërkesat shtesë për zbulimet mbi masat e përcaktuara nga menaxhmenti. Gjithashtu fondi po vlerëson ndikimin e këtij standarti në mënyrën e grupimit të informacionit në pasqyrat financiare, përfshirë elementet aktualisht të etiketuara si “te tjera”

B. Standarde të tjera kontabël

Këto standarde të reja dhe të rishikuara vijnë më poshtë.

- Mungesa e Shkëmbyeshmërisë
- Klasifikimi dhe matja e instrumentave financiare
- SNRF 19 (Filialet pa Kontabilitet Publik :Paraqitja)

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT

A. KLASIFIKIMI KONTABËL, VLERA E DREJTË DHE MATJA E VLERËS SË DREJTË

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas niveleve në hierarkine e vlerës së drejtë.

31 dhjetor 2024	Vlera Kontabël			Totali	Vlera e Drejtë			Totali
	Aktive Financiare me VDATGJ	Aktive Financiare me kosto te amortizuar	Detyrime te tjera financiare		Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
<i>Aktive financiare të matura me vlerë të drejtë</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Aktive financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>	-	-	-	-	-	-	22,780,570	22,780,570
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	22,780,570	-	22,780,570	-	-	22,780,570	22,780,570
Investime në letra me vlerë	-	2,488,758,602	-	2,488,758,602	-	-	2,677,151,114	2,677,151,114
<i>Detyrime financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	-	-	5,367,780	5,367,780	-	-	5,367,780	5,367,780
	-	2,511,539,172	5,367,780	2,516,906,952	-	-	2,705,299,464	2,705,299,464
31 dhjetor 2023	Vlera Kontabël			Totali	Vlera e Drejtë			Totali
	Aktive Financiare me VDATGJ	Aktive Financiare me kosto te amortizuar	Detyrime te tjera financiare		Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
<i>Aktive financiare të matura me vlerë të drejtë</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Aktive financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>	-	-	-	-	-	-	39,367,573	39,367,573
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	39,367,573	-	39,367,573	-	-	39,367,573	39,367,573
Investime në letra me vlerë	-	2,011,523,998	-	2,011,523,998	-	-	1,969,543,903	1,969,543,903
<i>Detyrime financiare jo të matura me vlerë të drejtë</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	-	-	4,205,548	4,205,548	-	-	4,205,548	4,205,548
	-	2,050,891,571	4,205,548	2,055,097,119	-	-	2,013,117,024	2,013,117,024

Aktivët financiarë të matura me vlerë të drejtë aplikojnë si teknike vlerësimi skontimin e fluksit të parasë. Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare jo të matura me vlerë të drejtë janë një përafrim i arsyeshëm i vlerave të drejta të përputhshme.

6. INSTRUMENTAT FINANCIARE-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT(VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RREZIKUTFINANCIAR

(i) Ekspozimet

Fondi është i ekspozuar nga risqet në vijim në lidhje me instrumentat financiar:

- Rreziku i kreditimit;
- Rreziku i likuiditetit;
- Rreziku i tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit me vlerë të drejtë, rrezikun e normës së interesit të fluksit monetar dhe rrezikun e çmimeve); dhe
- Rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion rreth objektivave, politikave dhe procedurave të Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut, ekspozimin ndaj disa rreziqeve financiare dhe administrimin e aktiveve neto të Fondit.

Fondi është po ashtu i ekspozuar ndaj rrezikut operacional siç mund të jetë rreziku i depozitarit. Rreziku depozitarit është rreziku i humbjes së investimeve të letrave me vlerë si pasojë e paftesisë paguese ose neglizhencës të depozitarit. Megjithatë një kuader ligjor i përshtatshëm është funksional që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës të investimeve të letrave me vlerë të mbajtura nga depozitari, në rast të falimentimit, mundësisë së Fondit për të transferuar investimet e letrave me vlerë mund të rrezikohet përkohësisht.

(ii) Kuadri i administrimit të rrezikut

Programi i përgjithshëm i administrimit të rrezikut të Fondit synon të maksimizojë kthimet për nivelin e rrezikut ndaj të cilit Fondi është i ekspozuar dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën financiare të Fondit. Funksioni i administrimit të rrezikut në kuadër të Fondit kryhet në lidhje me rreziqet financiare, rreziqet operationale dhe rreziqet ligjore.

Objektivat parësorë të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas të sigurojë se ekspozimi ndaj rreziqeve qëndron brenda këtyre kufijve. Funksionet e administrimit të rrezikut operacional dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operationale dhe ligjore. Fondi nuk përdor instrumente financiare derivative për të mbrojtur ekspozimet e këtyre rreziqeve.

Në bazë të ligjit të ri Nr. 76/2023 datë 6.11.2023 “Për fondet e pensioneve private” dhe ligjit “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” nr. 56/2020, miratuar më 30.04.2020, Shoqëria Administruese duhet të ketë një funksion të veçantë për administrimin e rrezikut. Menaxheri i Riskut është përgjegjës për administrimin e rrezikut dhe raporton tek Këshilli Administrimit .

Politikat janë zhvilluar në bazë të strukturës së Fondit të Pensioneve dhe Investimeve dhe tolerancës së riskut të vendosur në politikën e investimeve. Skema e Fondit është e tillë që kontributet janë të përcaktuara, ndërsa përfitimet nuk janë të përcaktuara. Dallimi kryesor është që rreziku mbahet plotësisht nga klientët që kontribuojnë. Toleranca e rrezikut është elementi kryesor që përcakton diferencën midis fondeve nën administrim dhe që së bashku me skemën e fondit qëndron në thelb të zhvillimit të politikës së menaxhimit të rrezikut.

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(iii) Depozitari

Në bazë të ligjit të ri Nr. 76/2023 datë 6.11.2023 “Për fondet e pensioneve private” aktivet e fondit të pensionit, duke përfshirë mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, duhet të mbahen me një depozitë të vetme, në një bankë të licencuar nga Banka e Shqipërisë, për sigurimin e shërbimeve të mbajtjes siç është miratuar nga Autoriteti i Shërbimeve Financiare për rolin depozitues. Shoqëria Administruese e Fondit ka marrëveshje me Bankën Tirana. Në përputhje me ligjin Nr. 76/2023 datë 6.11.2023 “Për fondet e pensioneve private” Banka ofron shërbime në lidhje me ruajtjen, depozitimin dhe besimin për aktivet e fondit. Funkcionet e depozitimit përfshijnë llogaritjen e vlerës së aktiveve neto të fondit të pensionit dhe raportimin në baza mujore të Shoqëria Administruese, duke siguruar që të ardhurat nga transaksionet që përfshijnë aktivet e fondit të pensionit shpërndahen/kapitalizohen tek kontribuesit e fondit të investimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke informuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për çdo çështje që mund të përbëjë një shkelje të legjislacionit ose kërcënimin e interesave të anëtarëve. Tirana Bank nuk është e vlerësuar.

iv) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një kundërpalë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet ose angazhimin që ka bërë me Fondin, me pasojë një humbje financiare për Fondin.. Ai lind kryesisht nga letrat me vlerë të borxhit të mbajtura dhe mjetet monetare dhe ekuivalentët me to. Për qëllime të raportimit për menaxhimin e rrezikut, Fondi konsideron këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku individual i mospagesës së debitorit, rreziku i shtetit dhe rreziku i sektorit). Administrimi i rrezikut të kreditimit të Fondit kryhet nga Shoqëria Administruese, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Investimet e Fondit janë në bonot e thesarit dhe obligacionet e Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Fondi është i ekspozuar vetëm ndaj rrezikut të kredisë së qeverisë shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal i Fondit ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	22,780,570	39,367,573
Investime në letra me vlerë me KA	2,488,758,602	2,011,523,998
	2,511,539,172	2,050,891,571

Alokimi strategjik i aktiveve është në përputhje me rregulloren nr.90, “Për aktivet e lejuara”, dhe ligjin nr. 76/2023 që përfshin vetëm instrumenta borxhi të emetuara nga Qeverisë Shqiptare e cila është vlerësuar si BB-, pozitiv, bazuar në vlerësimin e kredive të Standard & Poor's dhe Ba3, të qëndrueshëm, bazuar në vlerësimin e kredive të Moody's.

Politika e Investimit

Politika e Investimeve (PI) përbën dokumentin kryesor që kontrollon strategjinë e investimeve të Fondit. PI së bashku me Politikën e Menaxhimit të Rrezikut (PMR) përbëjnë dy dokumentet kryesore të Komitetit të Investimit (KI) për të administruar dhe realizuar objektivat kryesorë të fondit. Fondi do të menaxhohet në përputhje me ligjin e ri Nr. 76/2023 datë 6.11.2023 “Për fondet e pensioneve private” dhe me të gjitha rregulloret në fuqi. Elementët kryesorë të PI janë:

- Përcaktimi i qartë dhe ndarja e përgjegjësisë të të gjitha palëve të përfshira: Këshilli i Administrimit, Komiteti i Investimit, Anëtarët e Fondit (kontribuesit), dhe Depozitari;
- Përcaktimi i Objektivave dhe i kufizimeve të investimit;
- Përcaktimi i alokimit të aktiveve të fondit;
- Vlerësimi i performancës së fondit në krahasim me “benchmark-un” e përcaktuar;
- Vendosja e procedurës së komunikimit midis Këshillit të Administrimit, Depozitarit, dhe Komitetit të Investimeve

Fondi i Pensionit Privat "Credins Pension"
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT(VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(iv) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

Politika e Investimit (vazhdim)

Kufiri i investimeve të lejuara përcaktohet në rregulloren "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të Fondit të pensionit", miratuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare me vendimin e Bordit nr 154, datë 19 Shtator 2024:

Alokimi strategjik i aktiveve

Pjesa më e madhe e alokimit të aktiveve i përket bonove të thesarit dhe obligacioneve të qeverisë Shqiptare ("RSH") si në tabelën më poshtë:

Klasa e aktiveve	Min	Max	Limiti aktual	
			31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	1%	15%	1%	2%
Bono thesari, obligacione të emetuara nga Qeveria e RSH	70%	100%	99%	98%
Bono thesari, obligacione të shteteve anëtare të BE të denominuara në monedhën EUR	0%	30%	0%	0%

Politika Fiskale dhe Monetare e Shqipërisë ndikojnë ndjeshëm në normat e interesit të bonove të thesarit. Si të tilla ato do të monitorohen vazhdimisht për të përcaktuar ndikimin e tyre në aktivet e fondit. Megjithatë, meqenëse investimet e Fondit janë me interes fiks dhe mbahen për të mbledhur flukset monetare të ardhshme kontraktuale, ndryshimi i politikave monetare nuk ka efekt të menjëhershëm në aktivet e Fondit. Alokimi strategjik i aktiveve rishikohet nga Komiteti i Investimit një herë në vit. Rishikimi nuk nënkupton domosdoshmërisht ndryshim në politikën e investimit.

Cilësia e kredisë të aktiveve financiare është si më poshtë

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Niveli 1	TOTALI	Niveli 1	TOTALI
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	22,780,570	22,780,570	39,367,573	39,367,573
Investime në letra me vlerë me KA	2,488,758,602	2,488,758,602	2,011,523,998	2,011,523,998
Vlera kontabël	2,511,539,172	2,511,539,172	2,050,891,571	2,050,891,571

Investimet e letrave me vlerë

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së qeverisë shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve monetare në monedhën vendase në periudhën më të afërt. Në fund të muajit Mars 2024, agjencia ndërkombëtare e vlerësimit, Standard & Poor's, përmirësoi klasifikimin e borxhit publik afatgjatë të shtetit shqiptar nga 'BB-' në 'B+' që kishte mbajtur për një periudhë të gjatë. Agjencia kishte ndryshuar gjithashtu më parë perspektivën për Shqipërinë nga "stabël" në "pozitive". Për më tepër, agjencia ndërkombëtare e vlerësimit "Moody's" ndryshoi klasifikimin e saj më 18 tetor 2024, duke e rritur perspektivën e Shqipërisë nga "B1 - me perspektivë pozitive" në "Ba3 - stabël". Shqipëria ka arritur këtë nivel të klasifikimit të kredive për herë të parë, duke pritur që kjo të çojë në uljen e interesave të borxhit shtetëror në të ardhmen.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI RISKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(iv) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Fondi aplikon një bazë humbjeje të pritshme 12-mujore dhe reflekton maturitetet afatshkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të saj. Në aplikimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Fondi nuk ka njohur ndonjë zhvlerësim në 1 janar 2018 dhe shuma e saj nuk ka ndryshuar deri në vitin 2024.

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përllogaritjen e zhvlerësimit

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Fondi konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Fondit dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen. Fondi konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, kur një ose më shumë nga kriteret sasiore, cilësore ose kriteret mbështetëse në vijim janë plotësuar. Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Fondit. Fondi monitoron efektshmërinë e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë me ditëvonesa.

Përkufizimi i dështimit

Fondi konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Fondit, pa qenë nevoja për veprime nga Fondi të tilla si realizimi i aktive të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose

- debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Fondit.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Fondi konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;

- sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës;

Të dhënat e përdorura në vlerësimin e një instrumenti financiar nëse ka dështuar dhe se rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT(VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(iv) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përlllogaritjen e zhvlerësimit (vazhdim)

Mjetet financiare të ndryshueshme

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të ndryshohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpartisë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë ndryshuar mund të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 5.b

Kur kushtet e një aktivi financiar ndryshohen dhe ky nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm reflekton krahasimin e:

— PD-së përgjatë jetës së mbetur në datën e raportimit bazuar në kushtet e ndryshuara; me

— PD-në përgjatë jetës së mbetur vlerësuar në bazë të të dhënave në njohjen fillestare dhe kushteve kontraktuale fillestare.

Matje e HPK

Mjete monetare dhe ekuivalenete me to dhe depozitat me afat

Mjetet dhe ekuivalentët me to mbahen me bankat tregtare në Shqipëri. Fondi aplikon një bazë humbjejetë pritshme 12-mujore dhe reflekton maturitetet e shkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit. Në zbatimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Fondi nuk ka njohur një humbje nga zhvlerësimi. Në 31 Dhjetor 2024 Fondi ka vlerësuar që aktivet financiare janë kategorizuar si risk i ulët edhe nuk ka njohur asnjë shumë të lejuar

Investimet e letrave me vlerë

Të dhënat kryesore në matjen e HPK janë strukturat kohore të parametrave të mëposhtëm: - probabiliteti i dështimit (PD); - humbja nga dështimi (HND); - ekspozimi në rast dështimi (END). Vlerësimet e PD janë vlerësime në një datë të caktuar, të cilat llogariten në bazë të të dhënave të mbledhura brenda dhe jashtë, që përbëjnë faktorë sasiore dhe cilësorë. HND është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një dështim dhe vlerësohet bazuar në parametrat e llogaritur nga agjencitë e vlerësimit. END përfaqëson ekspozimin e pritshëm në rast të një dështimi. Fondi nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës duke përfshirë amortizimin. END i një aktivi financiar është vlera e tij kontabël bruto. Vlerësimet e END janë llogaritur në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës. Fondi mat HPK duke marrë në konsideratë rrezikun e vonësës për periudhën maksimale kontraktuale mbi të cilën ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse, për qëllime të administrimit të rrezikut, Fondi konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Fondi ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie. Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, Fondi nuk kishte aktive financiare me kredit të zhvlerësuar

Administrimi i kapitalit

Kapitali i fondit konsiston në aktivet neto që i atribuohen kuota mbajtësve.

Aktivneto që i atribuohen kuota mbajtësve i japin një investitori të drejtën për të kërkuar kthimin në mjete monetare në një vlerë të përpjestuar me pjesën e investitorit në aktivet neto të Fondit. Objektivat e Fondit në administrimin e aktiveve neto janë për të siguruar një bazë stabile të maksimizimit të kthimit të të gjithë investitorëve, dhe për të administruar rrezikun e likuiditetit që mund të krijohet nga tërheqjet.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

v) Rreziku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e tij financiare, që shlyhen duke dhënë mjete monetare ose ndonjë aktiv financiar tjetër. Politika e Fondit dhe përqasja e shoqërisë administruese në administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të respektuar detyrimet, nën kushte normale dhe stresi pa pësuar humbje të papranueshme ose pa rrezikuar reputacionin e Fondit. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është paraqitur në tabelën më poshtë:

31 dhjetor 2024	Vlera Kontabël	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6–12 muaj	1- 5 vite	Mbi 5 vite
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	22,780,570	22,780,570	-				
Investime në letra me vlerë me KA	2,488,758,602	5,305,577	-		17,098,164	558,982,365	1,907,372,497
Totali aktiveve	2,511,539,173	28,086,147			17,098,164	558,982,365	1,907,372,497
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	4,230,069	4,230,069	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	1,137,711	1,137,711	-	-	-	-	-
Total detyrimet	5,367,780	5,367,780	-	-	-	-	-
Ekspozimi neto	2,506,171,392	22,718,367	-		17,098,164	558,982,365	1,907,372,497
Ekspozimi neto i akumuluar		22,718,367	22,718,367	22,718,367	39,816,531	598,798,896	2,506,171,392
31 dhjetor 2023	Vlera Kontabël	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6–12 muaj	1- 5 vite	Mbi 5 vite
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	39,367,573	39,367,573					
Investime në letra me vlerë me KA	2,011,523,998	2,080,100	14,442,629	17,906,915	6,491,523	318,088,410	1,652,514,410
Totali aktiveve	2,050,891,571	41,447,673	14,442,629	17,906,915	6,491,523	318,088,410	1,652,514,410
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	3,455,745	3,455,745	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	749,803	749,803	-	-	-	-	-
Total detyrimet	4,205,548	4,205,548	-	-	-	-	-
Ekspozimi neto	2,046,686,023	37,242,125	14,442,629	17,906,915	6,491,523	318,088,410	1,652,514,410
Ekspozimi neto i akumuluar		37,242,125	51,684,754	69,591,669	76,083,192	394,171,602	2,046,686,012

6. INSTRUMENTAT FINANCIAR-VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

B. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

vi) Rreziku i tregut

“Rreziku i tregut” është rreziku që ndryshon çmimet e tregut-p.sh. norma e interesit, kursi i këmbimit dhe normat shtesë të kredisë-të cilat do të ndikojnë në vlerën e drejtë në mbajtjen e instrumentit financiar. Fondi nuk ndërmerr transaksione në monedha të huaja dhe për rrjedhojë nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset e mjeteve monetare. Periudha për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon në çfarë mase është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 Fondi nuk ka detyrime të rëndësishme me interes dhe prandaj rreziku i normës së interesit lidhet vetëm me aktivet financiare me interes. Çmimet e obligacioneve dhe normat e interesit janë të lidhura anasjelltas. Nga ana tjetër, një mjedis i ulët i normës së interesit e bën të vështirë për Fondin që të sigurojë një normë të mjaftueshme të brendshme të kthimit. Rritja / ulja paralele e kurbës së yield-eve me 100 bp për portofolin e titujve me të ardhura fikse do të rriste / ulte vlerën neto të aktiveve të Fondit për Lek 151,433 mijë (2023: Lek 120,228 mijë).

vii) Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë që del nga një shumëllojshmëri e shkaqeve të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Fondit, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kreditit, tregut dhe likuiditetit të tilla si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullative dhe standardet përgjithësisht të pranura të sjelljes së korporatave përjashtuar reputacionin dhe rrezikun strategjik. Qëllimi i Fondit është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia primare për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet Departamentit të Administrimit të Rrezikut. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Fondit për menaxhimin e rrezikut operacional dhe procedurat e brëndshme që mbështesin aktivitetin normal të operacioneve të biznesit.

viii) Rreziku i pensionit

Rreziku i pensionit konsiderohet kur Fondi ka ekspozime në rreziqet e mëposhtme nga instrumentat financiare. Individët përballen me dy rreziqe të rëndësishme kur mendojnë për zgjedhjen e kursimeve dhe investimeve për pension:

i) rreziku i tregut financiar (shih shënimin 6.b.iii-iv),

ii) rreziku i jetëgjatësisë,

Të jetuarit më gjatë nënkupton nevojën e zotërimit të më shumë burimeve për të përballuar kërkesat afatgjata për shpenzim. Rreziku i jetëgjatësisë, është mundësia që vlera e portofolit (kursimet e akumuluar) të ketë një jetëgjatësi më të vogël sesa jetëgjatësia e individit gjatë periudhës së pensionit. Investuesit janë të gatshëm të paguajnë një prim sigurimi për të shmangur këtë lloj rreziku. “Të përvitshmet” janë një produkt që konvertojnë investimin e akumuluar në të ardhura (benefite) që i paguhen klientit gjatë gjithë jetës (periudhës së pensionit) së mbetur. Përfitimi përgjatë jetës sigurohet duke e shtrirë rrezikun e jetëgjatësisë mbi një numër të madh të përvitshmesh dhe duke bërë supozime të kujdesshme dhe konservative mbi normën e kthimit që do të fitohet mbi aktivet.

Rreziku i mos-disbursimit apo shpenzimeve të tejkaluara, duke përfshirë këtu edhe rrezikun e inflacionit, rezultojnë në mos-përmbushjes e nevojave financiare në moshën e pensionit. Investuesit mund të mos kursejnë aq sa duhet për të financuar mjaftueshëm portofolet e pensionit. Skema me kontribute të përcaktuara kërkon këshillim financiar si përgjatë fazës së akumulimit ashtu edhe përgjatë fazës së tërheqjeve. Sfidat që mbart me vete skema e kontributeve të përcaktuara bën që klientët të zgjedhin alokimin e duhur të aktiveve si dhe produkte që do të sigurojnë një pension të përshtatshëm përgjatë jetës. Fondi përpaket të sigurojë këshillim financiar cilësor ndaj klientëve të tij.

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogaritë rrjedhëse	1,778,988	2,353,787
Depozitat me afat	21,000,000	37,000,000
Interesi i përlogaritur	1,582	13,786
	22,780,570	39,367,573

Depozita afatshkurtër përbëhet nga një depozitë shtate ditore e vendosur në Bankën e Tiranës me një normë interesi prej 2.75%

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË ME KOSTO TË AMORTIZUAR (KA)

Investime në letra me vlerë me kosto te amortizuar më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshte:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Vlera nominale	2,426,100,000	1,968,400,000
Prim i akumuluar	6,217,399	(740,282)
Çmimi i blerjes	2,432,317,399	1,967,659,718
Amortizimi i primit vjetor	(844,648)	(1,100,180)
Interes i përlogaritur	57,285,851	44,964,460
	2,488,758,602	2,011,523,998

Investime në letra me vlerë me obligacionet e Qeverisë Shqiptare me kosto të amortizuar kanë maturim mesatar prej 8 deri në 9 vjet dhe interes mesatar i ponderuar prej 6.085 % në vit. (2023: maturim mesatar prej 8 deri në 9 vjet dhe interes mesatar i ponderuar prej 6.29% në vit.). Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar nuk rezultojnë as me vonesë as të zhvlerësuar.

9. DETYRIME NDAJ SHOQERISE AMDINUSTRUESE

Detyrimi ndaj shoqërisë administruese në shumën prej Lek 4,230,069 (2022: Lek 3,455,745) përfaqëson tarifën e administrimit të përlogaritur në bazë ditore të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, e cila ishte e papaguar në fund të vitit. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024, totali i shpenzimeve për tarifën e administrimit të Fondit të Pensionit ishte në shumën Lek 45,428,772 ((2023: Lek 37,193,980).

10. TË ARDHURA NGA INTERESI

Të ardhura interesi janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura interesi nga investime në letra me vlerë me KA	141,768,126	113,129,291
Prime/(skontime)	(844,647)	(1,100,180)
Të ardhura interesi nga depozitat me afat	898,127	819,444
	141,821,606	112,848,555

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”
Shënime për pasqyrat financiare (vazhdim)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

11. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Palët konsiderohen të jenë të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar ose ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër për marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Fondin. Shoqëria Administruese dhe Depozitari janë të ngarkuar për të kryer rolin dhe përgjegjësitë e personelit kyç të drejtimit dhe për rrjedhojë, autoriteti dhe përgjegjësia për planifikim, drejtim dhe kontrollin e aktiviteteve të Fondit i është caktuar këtyre dy entiteteve dhe jo një personi ose individ.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe bilanceve të mbetura në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
<i>Tirana Bank</i>		
-Mjete monetare dhe ekuivalente me to	22,780,570	39,367,573
-Të ardhura interesi nga depozitat	4,230,069	3,455,745
<i>Credins Invest Sha</i>		
-Shpenzime	45,428,772	37,193,980
-Detyrime	4,230,069	3,455,745

12. NGJARJE PAS DATES SE RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas periudhës së raportimit që kërkojnë rregullim ose paraqitje në këto pasqyra financiare

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”
Skedulet suplementare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

I) Pasqyra e strukturës së investimeve

Përshkrim	31 dhjetor 2024				31 dhjetor 2023			
	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Vlera kontabël	% Aktiveve të Fondit	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Vlera kontabël	% Aktiveve të Fondit
Investime në letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar	2,426,100,000	2,432,317,399	2,488,758,602	99%	1,968,400,000	1,967,659,718	2,011,523,998	98%
Mjete monetare dhe ekuivalentë	-	-	22,780,570	1%	-	-	39,367,573	2%
	2,426,100,000	2,432,317,399	2,511,539,172	100%	1,968,400,000	1,967,659,718	2,050,891,571	100%

II) Pasqyra e humbjeve të realizuara të Fondit

Përshkrim	31 dhjetor 2024				31 dhjetor 2022			
	Vlera Nominale	Vlera Kontabël	Çmimi maturuar /shitur	Fitim/(humbje) realizuar	Vlera Nominale	Vlera Kontabël	Çmimi maturuar /shitur	Fitim/(humbje) realizuar
Investime në letra me vlerë të drejte përmes ATGJ	-	-	-	-	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë të mbajtura me KA	43,300,000	40,300,397	40,300,000	397	28,400,000	28,356,145	28,400,000	43,855
	40,300,000	40,300,397	40,300,000	397	28,400,000	28,356,145	28,400,000	43,855

Fondi i Pensionit Privat “Credins Pension”**Skedulet suplementare (vazhdim)***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***III) Pasqyra e fitimeve/(humbjeve) të parealizuara të Fondit**

Përshkrim	Kosto e blerjes	Vlera Kontabël 31.12.2024	Fitim i parealizuar nga ndryshimi çmimit	Ndryshimi neto i vlerës së investimit nga kursi i këmbimit	Amortizim i primit/(skontimit) i investimeve me KA	Zhvlerësim i aktivit
Investime në letra me vlerë të mbajtura me KA (treg primar)	1,842,056,939	1,842,232,351	-	-	175,411	-
Investime në letra me vlerë të mbajtura me KA (treg sekondar)	590,260,460	589,240,401	-	-	(1,020,059)	
	2,432,317,399	2,431,472,752	-	-	(844,648)	

Përshkrim	Kosto e blerjes	Vlera Kontabël 31.12.2023	Fitim i parealizuar nga ndryshimi çmimit	Ndryshimi neto i vlerës së investimit nga kursi i këmbimit	Amortizim i primit/(skontimit) i investimeve me KA	Zhvlerësim i aktivit
Investime në letra me vlerë të mbajtura me KA (treg primar)	1,456,835,886	1,456,649,376	-	-	(186,510)	-
Investime në letra me vlerë të mbajtura me KA (treg sekondar)	510,823,832	509,910,162	-	-	(913,670)	-
	1,967,659,718	1,966,559,538	-	-	(1,100,180)	